

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrete Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit A nga fshati e komuna e sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr.3218/15 të datës , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, në shqyrtimin gjyqësor në prezencën e Prokurorit të shtetit Elefete Purova, të dëmtuarës L V dhe të akuzuarit A A , me datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**AKT GJYKIM****I akuzuari:**

A A nga i ati J dhe e ëma F , i lindur me , në , tani banon në fshatin komuna e , i martuar, baba i tre fëmijëve, ndërtimtar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. të ID .

**ËSHTË FAJTOR**

Se më datën 10.10.2015 rreth orës 12:10 minuta në rrugën " , përballë stacionit policor, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzëve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës , me targa të regjistrimit vepron në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR -së , duke mos i'a përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve, gjendjes dhe rrethanave në rrugë si dhe duke mos patur kujdesin e shtuar në vendbanim, sidomos ndaj këmbësorëve kur vije në vendin kritik me pjesën e përparme të automjetit, e godet të dëmtuarën L V , e cila në atë moment po kalonte rrugën në vendin e shënuar për këmbësor, ku si pasojë e dëmtuara pëson lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të regjionit të krahut të dorës dhe nyjës (kyqit artikulacionit) të gjurit të këmbës së majtë.

Kështu që ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, të akuzuarit i'a shqipton:

**DËNIMIN ME KUSHT**

Duke ja vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.



I akuzuari, obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë ato, sipas llogarisë së bërë në arkën e kësaj gjykate, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 euro, dhe për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 40.88 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 3218/15 të datës 30.03.2016, kundër të akuzuarit A. A. nga fshati P. komuna e , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Gjykata më datën 23.05.2017 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në prezencën e prokurorit, të dëmtuarvës dhe të akuzuarit. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e pranojë fajësinë për veprën penale që më vihet në barrë dhe pranueshmërinë e provave. E dëmtuara L. V. ka deklaruar se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk do të parashtroj kërkesë pasurore juridike.

Gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se më datën 10.10.2015 rreth orës 12:10 minuta në P. në rrugën " ", përballë stacionit policor, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzëve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës "V.", me targa të regjistrimit 4. KS-07, vepron në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR -së, duke mos i'a përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve, gjendjes dhe rrethanave në rrugë si dhe duke mos patur kujdesin e shtuar në vendbanim, sidomos ndaj këmbësorëve kur vije në vendin kritik me pjesën e përparme të automjetit, e godet të dëmtuarën I. V., e cila në atë moment po kalonte rrugën në vendin e shënuar për këmbësor, ku si pasojë e dëmtuara pëson lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të regjionit të krahut të dorës dhe nyjës (kyqit artikulacionit) të gjurit të këmbës së majtë.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se në gjykim ka patur qëndrim korrekt, pranimi i fajësisë, nuk ka qenë i dënuar më parë. Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 453 par. 4 të KPP-së.


Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.675/16, me datë 23.05.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Shyhrete Sopaj**

**Gjyqtari**  
**Mehmet Ndrecaj**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.